

VENDIM

Nr.22, datë 30.11.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

“PËR PËRBËRJEN, NUMRIN DHE PROCEDURËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONEVE TË ANKIMIT PRANË DREJTORIVE RAJONALE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE”

Mbështetur në nenin 74, shkronja “e” dhe pikës 4, të nenit 86, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Administrativ i ISSH-së, në mbledhjen e tij të datës 30.11.2016

VENDOSI:

1. Të miratojë pa vërejtje, Rregulloren “Për përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Komisioneve të Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I

KËSHILLIT ADMINISTRATIV

Blendi KLOSI

RREGULLORE

“PËR PËRBËRJEN, NUMRIN DHE PROCEDURËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONEVE TË ANKIMIT PRANË DREJTORIVE RAJONALE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 86 dhe 74, gërma “e” të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore miraton këtë Rregullore mbi përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Komisioneve të Ankimit pranë Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore:

I. QËLLIMI

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë numrin e Komisioneve të ankimit, përbërjen dhe strukturën e tyre në të dy nivelet; të përcaktojë procedurën e dorëzimit të kërkesës ankimore dhe marrjes në shqyrtim të tyre; të japë zgjidhje të bazuara ligjore për ankimet; të caktojë procedurën e marrjes së përgjigjes së ankesës si dhe, në rastet e përgjigjeve të pafavorshme, të krijojë mundësinë e ankimit të personave në gjykatë.

II. PËRKUFIZIME

2. **“Komisioni Rajonal i Ankimit”** është organi kolegjal rajonal, i emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili organizohet dhe ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të nenit 86, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, dhe kësaj Rregulloreje, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave ankimore të qytetarëve ndaj vendimeve të Degës së Përfitimeve;
3. **“Komisioni Qendror i Ankimit”** është organi kolegjal qendror, i emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili ngrihet dhe ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të nenit 86, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe kësaj Rregulloreje, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave ankimore të qytetarëve ndaj vendimeve të Degës së Përfitimeve dhe vendimeve të Komisioneve Rajonale;
4. **“Ankimi dhe kërkesa ankimore”** është një peticion i shkruar i çdo qytetari, i cili pasi ka marrë një vendim përfundimtar nga Dega e Përfitimeve apo Komisioni Rajonal i Ankimit

për të drejtat e tij në lidhje me sigurimet shoqërore, shpreh kundërshtimin e tij të plotë apo të pjesshëm për vendimin e marrë;

5. **“Komisioni i Shqyrtimit dhe Vlerësimit të Dokumentave të Përfitimeve”** më poshtë *KSHVDP*, është një komision i veçantë i ngritur pranë DRSSH për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentave për periudhat e sigurimit, në rastet kur një specialist i vetëm nuk është në gjendje të marrë një vendim përfundimtar, për njohjen e periudhave të punës para vitit 1994;
6. **“Vendimi i Degës së Përfitimeve”** është një akt juridiko-administrativ, me anën e të cilit, personit të siguruar, i njihet ose refuzohet e drejta për një lloj përfitimi afatgjatë apo afatshkurtër nga sigurimet shoqërore (skema e detyrueshme), i cili bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
7. Me termin **“Dosje”**, të përdorur në këtë Rregullore, do të kuptohet dosja e administruar në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku është i inventarizuar i gjithë dokumentacioni për efekt përfitimesh afatgjata (pensione) apo përfitimesh afatshkurtra (sëmundje, barrëlindje, aksidente në punë/sëmundje profesionale), sipas kërkesave të rregulloreve në fuqi, të nxjerra në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
8. Me termin **“Praktikë”** të përdorur në këtë Rregullore, do të kuptohet tërësia e dokumentacionit të paraqitur, të vlerësuar dhe të refuzuar plotësisht me vendim të Degës së Përfitimeve;
9. Me termin **“Kompetencë lëndore”** të përdorur në këtë Rregullore kuptohet tërësia e të drejtave dhe detyrimeve që kanë komisionet për shqyrtimin e çështjeve në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

III. NUMRI I KOMISIONEVE DHE PËRBËRJA E TYRE

10. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore ngrihet Komisioni Qendror i Ankimit;
11. Komisioni Qendror i Ankimit përbëhet nga 4 (katër) anëtarë, specialistë të fushës së sigurimeve shoqërore dhe kryetari. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Ankimit emërohen e shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
12. Anëtarë të Komisionit Qendror të Ankimit zgjidhen specialistë të fushës së sigurimeve shoqërore, ndërsa kryetar i këtij komisioni mund të jetë drejtori i drejtorisë juridike, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

13. Anëtarët e Komisionit Qendror të Ankimit dhe kryetari qëndrojnë në këto komisione deri në 5 vjet. Për arsye të përligjura dhe anëtarë të veçantë, afati i caktuar mund të përsëritet apo mund të zgjatet. Për arsye të përligjura ai edhe mund të ndërpritet;
14. Në 12 (dymbëdhjetë) Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ngrihen Komisionet Rajonale të Ankimit;
15. Komisionet Rajonale të Ankimit përbëhen nga 3 anëtarë dhe kryetari. Anëtarët e komisioneve mund të jenë specialistë të përfitimeve, kontributeve, financës apo arkivës, ndërsa kryetari duhet të jetë patjetër jurist i DRSSH-së;
16. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Rajonal të Ankimit emërohen dhe shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së, me propozim të Drejtorit të DRSSH-së.

IV. OBJEKTI I PUNËS SË KOMISIONEVE TË ANKIMIT DHE KOMPETENCAT

17. Komisionet e Ankimit shqyrtojnë kërkesat dhe ankesat e personave për pensionet e pleqërisë, invaliditetit, pensionet familjare, si dhe çdo përfitim tjetër të njohur sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
18. Komisionet e Ankimit shqyrtojnë paraprakisht nëse kërkesa ankimore është në kompetencën lëndore të tyre, si dhe nëse ajo bën pjesë në juridiksionin administrativ. Në çdo rast ato kanë detyrimin të shprehen me vendim;
19. Komisionet e Ankimit shqyrtojnë çdo kërkesë ankimore në lidhje me të drejtën e përfitimeve, kohën e fillimit të pagesës, masën e përfitimit dhe mënyrën e llogaritjes së saj, njohjen e periudhave të punës apo atyre kontributeve, konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, dokumentacionit të paraqitur dhe bindjes së krijuar;
20. Ato gjithashtu kanë detyrimin të vlerësojnë nëse janë zbatuar drejt procedurat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe rregulloret përkatëse të përfitimeve apo kontributeve;
21. Komisionet e Ankimit nuk kanë të drejtë të shprehen për çështje që bëjnë pjesë në kompetencën e KMCAP-eve Rajonale apo Eprore. Në rast se konstatohet se çështja e ardhur për shqyrtim bën pjesë në kompetencën e KMCAP-eve Rajonale apo KMCAP-eve Eprore, Komisionet e Ankimit përcjellin kërkesën ankimore, sipas rastit, pranë KMCAP-eve Rajonale apo KMCAP-eve Eprore;
22. Në rast se Komisioni Qendror i Ankimit konstaton shkelje ligjore, mosrespektim të Rregullores së pensioneve, moszbatim të kësaj Rregulloreje, apo moszbatim të udhëzimeve dhe përmbajtjes së shkresave përgjithësuese nga Degët e përfitimeve apo Komisionet Rajonale të Ankimit, informon me shkrim Drejtorin e Përgjithshëm të ISSH-së dhe rekomandon marrjen e masave administrative;

23. Komisionet e Ankimit realizojnë studime në lidhje me rastet e përsëritura të interpretimit të ndryshëm të akteve ligjore dhe nënligjore, paraqesin raporte vjetore pranë Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore mbi ecurinë e rasteve të shqyrtuara dhe tematikën e trajtuar, duke bërë edhe propozime për ndryshime apo interpretime ligjore përgjithëse.

V. VLERËSIMI I KËRKESAVE ANKIMORE DHE PROCEDURA

V. A. Kërkesat ankimore, procedura dhe vlerësimi në Komisionin Rajonal të Ankimit

24. Ankimi, kundër vendimeve të Degës së Përfitimeve të Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, i drejtohet Komisionit të Ankimit pranë të njëjtës drejtori, nëpërmjet kërkesës me shkrim, sipas formatit tip bashkëlidhur kësaj Rregulloreje;
25. Afati për paraqitjen e kërkesës ankimore kundër Degës së Përfitimeve është brenda 30 ditëve, nga data e marrjes dijeni për vendimin e kundërshtuar për personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa për personat jo rezidentë në Shqipëri do të jetë brenda 90 ditëve, nga data e marrjes dijeni për vendimin e kundërshtuar;
26. Qytetarët i paraqesin kërkesat e tyre ankimore në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore. Këto kërkesa regjistrohen në një regjistër të veçantë dhe dorëzohen në protokollin e DRSSH-së, të shoqëruara me procesverbal. Për ALSSH-të që kanë qendrën e tyre brenda qytetit (bashkisë) ku ndodhet DRSSH-ja, ato dorëzohen brenda ditës së nesërme të punës. Ndërsa për ALSSH-të që kanë qendrën e tyre jashtë territorit të qytetit (bashkisë) ku ndodhet DRSSH-ja, brenda 5 ditëve të punës. Nga protokollin kërkesat ankimore i dorëzohen zyrtarisht kryetarit të Komisionit Rajonal të Ankimit;
27. Kryetari i Komisionit Rajonal të Ankimit, pas marrjes së kërkesave ankimore, i regjistron ato në një regjistër të veçantë dhe, brenda javës së parë të punës, dosja dhe dokumentet shqyrtohen në mbledhjen e radhës së Komisionit;
28. Në mbledhjen e radhës Komisioni Rajonal shqyrton paraprakisht dokumentacionin e dosjes/praktikës dhe vlerëson nëse:
- i) Çështja e ankimuar bën pjesë në kompetencën lëndore dhe territoriale të komisionit,
 - ii) Dega e Përfitimeve ka marrë vendim përfundimtar në lidhje me çështjen e ankimuar,
 - iii) Dokumentacioni në dosje është i plotë. Komisioni Rajonal i Ankimit nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesat ankimore pa dokumentacionin e plotë në dosje, apo pa vendimin përfundimtar, të plotë dhe të arsyetuar qartë nga Dega e përfitimeve.
29. Në rastet kur Komisioni konstaton se:

- i) çështja e ankimuar nuk bën pjesë në kompetencën e tij lëndore, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë kompetencës dhe sqaron personin e interesuar për organin të cilit duhet t'i drejtohet për realizimin e të drejtës së tij,
 - ii) çështja e ankimuar nuk bën pjesë në kompetencën e tij territoriale, dërgon zyrtarisht kërkesën ankimore pranë Komisionit Rajonal të rajonit që ka kompetencën territoriale për shqyrtimin e kërkesës ankimore,
 - iii) Dega e përfitimeve nuk ka marrë vendim përfundimtar në lidhje me çështjen e ankimuar, dërgon menjëherë dosjen/praktikën për vendim pranë Degës së përfitimeve, duke përcaktuar edhe afatin për marrjen e vendimit. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 5 ditë pune,
 - iv) dokumentacioni në dosje nuk është i plotë, ose duhet të shqyrtohet një provë tjetër, kthen zyrtarisht dosjen/praktikën në Degën e përfitimeve dhe kërkon plotësimin e saj me dokumentacionin e nevojshëm, brenda 15 ditëve të punës.
30. Në rastet kur, pas plotësimit të dokumentacionit, Dega e Përfitimeve konstaton se çështja e ankimuar mund të zgjidhet në favor të personit, njofton zyrtarisht Komisionin Rajonal të Ankimit dhe vë në dijeni gjithashtu edhe personin e interesuar;
31. Në rastet kur pranohet pjesërisht kërkesa, dosja i përcillet Komisionit për të vijuar me procedurën e shqyrtimit për pjesën e refuzuar;
32. Në rastet ku Komisioni Rajonal vlerëson se zgjidhja përfundimtare e çështjes mund të realizohet vetëm nëpërmjet një vendimi gjykate për njohje të viteve të punës, apo saktësimi dokumenti, i cili nuk bën pjesë në rastet e përcaktura për zgjidhje nga Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentave të përfitimeve (KSHVDP), Komisioni merr vendim për pezullimin e procedurës së vlerësimit deri në 1 vit, duke e përcaktuar në vendim të drejtën e qytetarit për të zgjidhur fillimisht çështjen në rrugë gjyqësore. Në rast se qytetari nuk është dakort me këtë vendim të Komisionit Rajonal, mund ta kundërshtojë atë në Komisionin Qendror të Ankimit, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni. Komisioni Qendror i Ankimit është i detyruar të shprehet brenda 5 ditëve të punës mbi çështjen e juridiksionit
33. Komisioni Rajonal do të mbajë në ruajtje dosjen/praktikën deri në përfundimin e procesit gjyqësor. Kur procesi gjyqësor ka filluar dhe nuk ka përfunduar brenda një viti nga data e pezullimit të vendimit, Komisioni Rajonal me vendim të argumentuar e shtyn afatin e pezullimit edhe 6 muaj të tjerë;
34. Komisioni Rajonal i Ankimit pranon dosjen/praktikën e ankimuesit dhe e shqyrton atë pasi e gjen të plotë dhe të rregullt dhe merr vendim përfundimtar për:
- a) pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të DRSSH-së;
 - b) rrëzimin e kërkesës së ankimuesit dhe lënien në fuqi të vendimit të degës së përfitimeve;

- c) mospranimin për shqyrtim të kërkesës për mungesë të kompetencës lëndore, për të gjitha rastet të cilat nuk janë parashikuar në Ligjin n. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - d) Kur gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore rezultojnë disa pretendime, nga të cilat një pjesë pranohen dhe një pjesë tjetër rrëzohen, Komisioni merr vendim për pranimin pjesërisht të kërkesës, duke specifikuar se cilat pretendime pranon dhe cilat pretendime rrëzon, duke ndryshuar pjesërisht vendimin e Degës së Përfitimeve, si dhe duke përcaktuar qartë dhe saktë atë pjesë të vendimit të Degës, që e shfuqizon dhe atë pjesë të vendimit që e lë në fuqi;
35. Vendimi i KRA i komunikohet zyrtarisht Degës së Përfitimeve dhe personit të interesuar;
36. Në rast se pretendimet, të cilat nuk pranohen, lidhen me njohjen e periudhave të vjetërsisë në punë me anë të një vendimi gjyqësor, zbatohen procedurat e përcaktuara në paragrafin 32 të kësaj rregulloreje;
37. Në rastet kur rrëzohet kërkesa ankimore, në vendim duhet të pasqyrohet procedura e mëtejshme e ankimit administrativ në Komisionin Qendror të Ankimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
38. Vendimet e Komisionit Rajonal të Ankimit shoqërohen me shkresë përcjellëse të Drejtorit të DRSSH-së;
39. Vendimet mbahen në dy kopje. Një kopje e vendimit të KRA-së së bashku me shkresën përcjellëse, përmes ALSSH-së që ka pritur kërkesën ankimore, i dërgohet ankuesit në adresën e tij të banimit dhe kopja tjetër administrohet në dosje. Në kopjen e vendimit të KRA-së që mbetet në dosje, duhet të jetë edhe nënshkrimi i ankuesit, i cili pajiset me kopjen e tij të vendimit. Në rastet kur personi kërkues nuk paraqitet pranë ALSSH-së për të tërhequr vendimin brenda 30 ditësh nga data që vendimi depozitohet në ALSSH, kjo e fundit merr masa që vendimi t’i dërgohet ose komunikohet personit zyrtarisht me rrugë postare;
40. Në rast se ankuesi nuk mund të paraqitet vetë për të tërhequr vendimin, ky i fundit mund të tërhiqet nga një person i pajisur me prokurë nga ankuesi. Prokura administrohet në dosje;
41. Ankuesi konsiderohet i njoftuar kur është pajisur me kopjen e tij të vendimit të KRA-së dhe shkresën përcjellëse të Drejtorit Rajonal, fakt që provohet me nënshkrimin nga ana e ankuesit apo përfaqësuesit të tij me prokurë të kopjes së vendimit që mbetet në dosje. Në rastet kur personi nuk është paraqitur për tërheqjen e ankimit dhe ky i fundit është dërguar me postë, si datë e marrjes dijeni do të konsiderohet dita pasardhëse e datës në vulën postare.

V.B. Kërkesat ankimore, procedura dhe vlerësimi në Komisionin Qendror të Ankimit

42. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin Qendror të Ankimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
43. Ankuesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni të vendimit të Komisionit Rajonal, personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesit të tij me prokurë, ka të drejtë të depozitojë kërkesën ankimore kundër vendimit të Komisionit Rajonal, në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore, ku ka qendrën e tij të banimit, ose ta dërgojë atë në rrugë postare në adresë të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore apo Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
44. Kur kërkesa ankimore depozitohet në ALSSH apo dërgohet me postë në DRSSH, kjo e fundit, brenda javës së parë të punës, dërgon në adresë të Komisionit Qendror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kërkesën ankimore së bashku me dosjen/praktikën dhe vendimet e Degës së Përfitimeve dhe Komisionit Rajonal të Ankimit;
45. Kur kërkesa ankimore depozitohet në rrugë postare pranë Komisionit Qendror të Ankimit në ISSH, sekretari i këtij Komisioni, brenda 5 ditëve të punës, përgatit shkresën zyrtare për DRSSH-në vendimarrëse, për sjelljen e dosjes/praktikës për shqyrtim në Komisionin Qendror të Ankimit;
46. Kryetari i Komisionit Rajonal të Ankimit pranë DRSSH-së me të marrë një kërkesë të tillë, përgatit dosjen/praktikën dhe vendimet përkatëse të Degës së Përfitimeve dhe Komisionit Rajonal të Ankimit dhe, brenda 5 ditëve të punës, i dërgon ato në adresë të Komisionit Qendror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
47. Në rast se konstatohet se Dega e përfitimeve dhe Komisioni Rajonal i Ankimit nuk kanë marrë vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën ankimore, Kryetari i Komisionit Rajonal të Ankimit, e dërgon atë pranë Degës së përfitimeve për marrjen e vendimit përfundimtar dhe, në rast vendimi jo të favorshëm, Komisioni Rajonal i Ankimit me iniciativë, merr në shqyrtim çështjen dhe shprehet me vendim përfundimtar. Të dy procedurat, në Degën e përfitimeve dhe Komisionin Rajonal të Ankimit, kryhen brenda 10 ditëve të punës dhe i dërgohen Komisionit Qendror të Ankimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
48. Kërkesa ankimore regjistrohet në protokoll dhe në regjistër elektronik të sekretarisë së Komisionit Qendror. Kryetari i Komisionit ia kalon dosjen për shqyrtim anëtarit të Komisionit, i cili përgatitet për relativim në mbledhjen e radhës. Shqyrtimi i kërkesës ankimore dhe marrja e vendimit duhet të përfundojnë brenda datës së fundit të muajit pasardhës nga data e protokollimit të dosjes në ISSH;
49. Në raste të veçanta, për siguri në marrjen e vendimeve, Komisioni Qendror i Ankimit kërkon zyrtarisht verifikime të veçanta të vjetërsisë në punë apo dokumenta specifike, të cilat janë në funksion të çështjes;
50. Në rastet kur Komisioni Qendror konstaton se njohja e periudhave të sigurimit apo njohja e një dokumenti të paraqitur, i tejkalon kompetencat e organit administrativ, ai merr vendim

për pezullimin e procedurës për marrjen e vendimit deri në 1 vit dhe orienton ankuesin që t'i drejtohet gjykatës. Dosja kthehet në Komisionin Rajonal, ku mbahet në ruajtje, deri në përfundimin e procedurës gjyqësore;

51. Komisioni shqyrton çështjen dhe merr vendim përfundimtar për:

- i) pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të DRSSH-së dhe të KRA-së,
- ii) rrëzimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të vendimit të DRSSH-së dhe të KRA-së,
- iii) mospranimin për shqyrtim të kërkesës për mungesë të kompetencës lëndore, pra të gjitha rastet të cilat nuk janë parashikuar në Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- iv) Kur gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore rezultojnë disa pretendime nga të cilat një pjesë pranohen dhe një pjesë tjetër rrëzohet, Komisioni merr vendim për pranimin pjesërisht të kërkesës dhe ndryshimin pjesërisht të vendimit të DRSSH-së e KRA-së, duke specifikuar cilat pretendime pranon dhe cilat pretendime rrëzon, si dhe duke përcaktuar qartë dhe saktë atë pjesë të vendimit të DRSSH-së e KRA-së, që e shfuqizon dhe atë pjesë të vendimit të DRSSH-së e KRA-së, që e lë në fuqi.

52. Vendimi përfundimtar i Komisionit Qendror të Ankimit është i detyrueshëm për zbatim. Ky vendim kundërshtohet vetëm në gjykatë;

53. Vendimi i Komisionit Qendror të Ankimit shoqërohet me shkresë përcjellëse nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

54. Vendimet e KQA-së mbahen në tre kopje. Një kopje i jepet ankuesit, një kopje administrohet në dosje dhe kopja e tretë i bashkëlidhet ankesës dhe administrohet në protokollin e ISSH-së. Në kopjen e vendimit të KQA-së që mbetet në dosje, duhet të administrohet deklarimi dhe nënshkrimi i ankuesit, apo përfaqësuesit të tij me prokurë të posaçme, që është pajisur me vendimin e KQA-së;

55. Në rastet kur personi kërkues nuk paraqitet pranë ALSSH-së, për të tërhequr vendimin brenda 60 ditësh nga data që vendimi depozitohet në ALSSH, kjo e fundit merr masa që vendimi t'i dërgohet ose komunikohet personit zyrtarisht, me rrugë postare. Në këtë rast si datë e marrjes dijeni do të konsiderohet dita pasardhëse e datës në vulën postare;

56. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar.

VI. TË PËRGJITHSHME

57. Komisionet e Ankimit, në nivel rajonal dhe qendror, mblidhen periodikisht, por jo më pak se 1 herë në muaj. Ditën e mbledhjes kërkesat ankimore dhe dosjet përkatëse të shqyrtuara më parë, relatohen nga anëtarët, respektivisht sipas shpërndarjes së dosjeve;

58. Komisionet e Ankimit mblidhen kur janë të pranishëm së paku $\frac{3}{4}$ e numrit të anëtarëve. Në rast se mungon kryetari ai zëvendësohet nga anëtari me vjetërsi profesionale më të madhe;
59. Vendimet, në të dy nivelet e Komisioneve, merren me shumicën e thjeshtë të votave. Kur votat e anëtarëve janë të barabarta, përcaktuese është vota e Kryetarit;
60. Secili nga anëtarët ka të drejtë që mendimin e vet në pakicë, të argumentuar t'ia bashkëlidhë mendimit të shumicës;
61. Në rastet kur ankuesi heq dorë nga ankimi, Komisioni merr vendim për mosshqyrtim për këtë shkak, duke administruar në dosje deklaratën me shkrim të ankuesit për heqjen dorë nga ankimi;
62. Kur konstatohen gabime materiale në një vendim të secilit prej Komisioneve, ai Komision që ka marrë vendimin, bën ndreqjen e gabimit me anë të një shtojce vendimi, duke cituar gabimin material të bërë gjatë zbardhjes së vendimit, duke bërë referencën tek burimi i saktë dhe duke specifikuar se është i njëjti vendim i marrë mbi të njëjtat dokumente të inventarizuara në dosje, në kohën e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit;
63. Vendimet e Komisionit Rajonal të Ankimit janë objekt i inspektimit dhe auditimit nga strukturat përkatëse në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, por nuk mund të ndryshohen. Për rastet e kontestuara, ato do të shqyrtohen nga Komisioni Qendror i Ankimit, si organi i vetëm, i cili mund të ndryshojë këto vendime;
64. Anëtarët dhe kryetarët e Komisioneve të Ankimit i kryejnë këto funksione kundrejt shpërblimit. Shpërblimi është mujor, jepet një herë në muaj, kur zhvillohen mbledhje, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të realizuara gjatë muajit. Masa e shpërblimit të Komisioneve të Ankimit përcaktohet me vendim të Këshillit Administrativ. Shpenzimet përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
65. Rregullorja nr. 6, datë 25.05.2009 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve të Apelit në Sistemin e sigurimeve shoqërore”, e ndryshuar, shfuqizohet;
66. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I
KËSHILLIT ADMINISTRATIV**

Blendi KLOSI